



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 55.
Prishtinë, më 20.11.2012 në ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues i OSB-së Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësuese i Sekretariatit të KKK Zijush Ahmeti, përfaqësues i zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinate - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu dhe praktikanti nga NDI-ja Visar Bikliqi.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-120 për mbrojtjen e Bimëve me raportin e komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor , me amendamente;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 154 për punimet nga metalet e çmuara, me raportin e komisionit Funkcional për Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë, me raportin e komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, me amendamente ;**
6. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara.

Kryesuesi - konstatoi se komisioni, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 6.11.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-120 për mbrojtjen e Bimëve me raportin e komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor , me amendamente;

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-120 për mbrojtjen e Bimëve, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohej nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funkcional.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-120 për mbrojtjen e Bimëve dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 154 për punimet nga metalet e çmuara, me raportin e komisionit Funkcional për Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L- 154 për punimet nga metalet e çmuara, dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L- 154 për punimet nga metalet e çmuara dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë, me raportin e komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, me amendamente ;

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente.

Glauk Konjufca – Duke pasur parasysh faktet se nga viti 2008, Kosova ka pasur krizë financiare dhe nga pamundësia për të pasur depozita të siguruara, më se shumti kanë pësuar qytetarët tanë. Ai diskutoi se gjatë periudhave të ardhshme, deri më 2018 do jenë në dispozicion vetëm 3000 euro, ky projekt nuk është në përputhje me nevojat dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës. Gjegjësisht ne do të paraqesim amendamente, me qëllim që të ketë garanci më të mirë për qytetarët. Njëherit, pajtohet për votim të projektligjit në fjalë.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, pas shqyrtimit të raportit me amendamente të Komisionit Funksional, nxjerrë nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme.

Glauk Konjufca - ai tha se komisioni në vazhdimësi ka bërë thirrje Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Plaifikimit Hapsinor dhe institucionet tjera përgjegjëse, lidhur me çështjen e komunitetit Romë Ashkalinjë dhe Egjiptian, që jetojnë në pjesën jugore të Mitrovicës e të cilët janë të rrezikuar me praninë e helmit me plumb. Gjithashtu, komisioni ka marrë raportin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe në veçanti kemi vërejtjet tona konkrete. Ishte i mendimit të diç për rrjedhën e vizitës në terren lidhur me zhvillimet e procesit për mbrojtjen e komuniteteve në fjalë. Propozimi i tij ishte që aktualisht të kemi raportin me shkrim, më pas të diskutohet për orientimet e përgjithshme të komisionit që ne përfaqësojmë.

Petar Miletic- pajtohet me parafralimin, se komisioni nuk mundë të diskutojë lidhur me këtë çështje deri sa nuk e kemi raportin me shkrim.

Kryesuesi – ai ceku se në mbledhjet e fundit, komisioni ka diskutuar lidhur me zhvillimet e çështjes së komunitetit Romë, Ashkalij dhe Egjiptian. Për realizimin e vizitës në terren, në veçanti falenderoi anëtarët e komisionit, ministrin z.Ferid Aganin dhe drejtorin e KK të Mitrovicës që udhëheq këtë resor.

Ai tha se gjatë realizimit të vizitës është vërejtur progres në integrimin e këtyre tri komuniteteve, si në shkollim, në punësim dhe në të gjitha sferat përkatëse. Infrastruktura e banimit ishte në nivel shumë të mirë nga se komuniteteve në fjalë ua janë ndërtuar shtëpi të reja.

Theksoi se jemi dëshmitar në marrjen e analizave të rregullta, në gjakun e fëmijëve ku dhe ministri z. Ferid Agani dëshmoi se nuk ekzistojnë raste me doze të plumbit më tepër se që është e lejuar. Shprehu qëndrimin e tij se duhet falënderuar Organizatën Ndërkombëtare MeryCorps, e cila ka bashkëpunuar me Qeverinë e Kosovës dhe strukturat komunale të Mitrovicës, për të arriturat e zhvendosjes së komunitetit Romë, Ashkalij dhe Egjiptian në zonën jugore të Mitrovicës. Pajtohet që raporti me shkrim të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

Albert Kinolli, ai falenderoi koleget për vizitën e realizuar. Poashtu, ne si deputet jemi konsultuar edhe me ministrin z. Agani, përfaqësuesit e ministrisë për komunitete dhe kthim, zyrës për komunitete, përfaqësuesit e ministrisë dhe planifikimit hapësinor si dhe dy nënkryetarëve të Komunës së Mitrovicës.

Në pika të shkurta foli se tani gjindemi para një situate shumë më e favorshme, 136 familje janë kthyer në pjesën Jugore të Mitrovicës, janë ndërtuar 122 shtëpi për 2.000 pjesëtarë të këtyre komuniteteve, janë renovuar 14 shtëpi. Të dhënat më të detajuara janë të përfshira në procesverbalin e mbledhjes së datës 6.11.2012.

Njëherit u pajtua që raporti me shkrim, të shqyrtohet për mbledhje të radhës.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic